

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 623 Prot.

Tiranë, më 10.062016

VENDIM Nr. 60, datë 08.06.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7 të datës 08.06.2016, pasi shqyrtoi Relacionin për verifikimin e punimeve në kuadër të *projektit të rrugës Levan-Tepelenë, Loti 2, pranë fshatit Qesarat*, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

1. Të miratojë Relacionin për verifikimin e punimeve në kuadër të *projektit të rrugës Levan-Tepelenë, Loti 2, pranë fshatit Qesarat*, realizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
2. Në vijim të konceptit të sondazhe arkeologjike të kryera nga shoqëria e licencuar në arkeologji "K.A.E.XH." sh.p.k., të realizohet gërmimi arkeologjik i shpëtimit nga kjo shoqëri, në zonën ku janë evidentuar gjurmë muresh pranë ish-vatrës së Kulturës, Qesarat, nga KM 15+10.000 deri në KM 15+65.000, me qëllim dokumentimin e gjetjeve arkeologjike dhe sqarimin e situatës, duke lidhur paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe ndërmjet investitorit, kësaj shoqërie dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë atë. Raporti i tij do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të kontratës tre palëshe.
4. Gjatë zbatimit të punimeve të mëtejshme të projektit, të realizohet mbikqyrja arkeologjike nga DRKK Gjirokastër, e cila duhet të depozitojë pranë Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dokumentacionin për të, duke lidhur më parë akt-marrëveshje tre palëshe me ASHA dhe investitorin, sipas vendimit të KKA Nr. 102, datë 1.09.2015.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA**  
**RUDINA ZOTO**

